



Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Gjatë muajit maj është mbajtur seminari i fundit “Planifikimi dhe Vlerësimi” për 25 grupe që janë duke u trajnuar në kuadër të Programit “Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit- MKLSH”. Në bazë të fletë vlerësimeve arrihet në konkluzionin se të gjithë mësimeve kanë qenë të kënaqur me programin e trajnimit dhe udhëheqjen e seancave nga ana e trajnerëve. Në veçanti është potencuar prezantimi i matricës së testit dhe përgatitja e testeve objektive. Pothuajse çdo fletë vlerësim ka propozimin se këtë program trajnimi duhet vijuar çdo mësimeve. Në fund të seancave të trajnimit, trajnerët kanë njoftuar mësimeve për datën e certifikimit. Vlen të theksohet se në Kaçanik nga 32 pjesëmarrës që kanë qenë në fillim, vetëm 21 kandidatë plotësojnë kushtet për certifikim. Të tjerët kanë humbur të drejtën për shkak të mungesave. Një mos angazhim i Zyrës Rajonale të Arsimit në Ferizaj ka sjellë deri te situata që njerëzit e përzgjedhur të mos jenë të interesuar për trajnim dhe ta braktisin këtë trajnim, ndërsa në anën tjetër ka shumë të interesuar që pyesin se si mund të përfshihen në trajnim.

■ Gjatë muajit maj është mbajtur dhe takimi gjysmë ditor dhe seminari i fundit me mësimeve që janë duke u trajnuar në Istog. Sipas raportit të trajnerëve shihet se çdo gjë ka shkuar sipas planifikimit.

■ Në kuadër të MKLSH, gjatë muajit qershor do të certifikohen afër 930 mësimeve në mbarë Kosovën.

Trajnimi i mësimeve të historisë

Në muajin maj është nënshkruar kontrata me Qendrën për Demokraci dhe Pajtim në Evropën Juglindore (CDRSEE) për trajnimin e 60 mësimeve të Historisë. Seminaret do të organizohen gjatë muajit qershor në Prishtinë (2 grupe) dhe një në Gjakovë.

Hap pas Hapi

■ Në kuadër të programit Hap pas Hapi, gjatë muajit maj janë zhvilluar këto aktiviteteve:

- Në Pejë me datat 3-5 maj u mbajtën dy trajnime avancues, të cilat u financuan bashkërisht nga KEC dhe MASHT.
- Në Ferizaj me datat 24, 25, 26 maj u mbajt trajnimi avancues për klasën e parë.
- Në Prizren me datat 31 maj dhe 1,2 qershor u mbajt trajnimi avancues për klasën e parë.
- Me datat 31 maj dhe 1,2 qershor, u mbajt trajnimi për klasën e katërt për regjionin e Mitrovicës. Ky është trajnimi i fundit për këtë grup.

■ Në zyrat e KEC u mbajt trajnimi fillestar për edukatorët të cilat punojnë me grup moshat 3-6. Ky trajnim u mbajt nga data 26-30 maj. Grupi i formuar, do të vazhdojë trajnimin avancues në nëntor.



Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim

- Në kuadër të projektit Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim, filloi cikli i tretë i trajnimeve të 500 mësimeve. Këtë radhë trajnimet do të mbahen në: Kamenicë, Podujevë, Istog, Klinë, Drenas dhe Prizren.
- Në Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë dhe Prishtinë u mbajtën kampanja për ngritjen e vetëdijes për gjithpërfshirjen e fëmijëve në arsim. Ka mbetur të realizohet edhe kampanja në Gjilan.

Projekti për përmirësimin e pjesëmarrjes në Arsim PPPA II

- Në kuadër të projektit janë përzgjedhur shkollat pjesëmarrëse në ciklin e dytë. Gjithsej në këtë cikël janë përzgjedhur 46 shkolla nga tri rajone në të cilat implementohet projekti: Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë. Përfaqësuesit e këtyre shkollave janë në fazën e trajnimit në dy programe: Plani Zhvillimor i Shkollës dhe Planifikimi i Projekteve Shkollore. Pritet që deri në muajin korrik këto shkolla të hartojnë

projektet shkollore të cilat do të dorëzohen për aprovim në dy nivele. Në nivelin lokal ato do të shqyrtohen nga Ekipi Komunal për Grante Shkollore (EKGS), ndërsa në nivelin qendror nga Këshilli për Aprovimin e Granteve Shkollore (KAGS). Më pas, deri në tetor pritet realizimi i këtyre projekteve shkollore.



- Po bëhen përgatitjet për fillimin e implementimit të komponentës së dytë të projektit, komponentës së granteve komunale për zhvillim. Barra kryesore në implementimin e granteve komunale do ta bart Komiteti Komunal për Grantin Arsimor (KKGA), i cili do të përbëhet nga pesë anëtarë: Drejtori Komunal i Arsimit, Zyrtari për Financa të Drejtorisë Komunale të Arsimit, dy përfaqësues të shkollave, dhe një përfaqësues i komunitetit.

Monitorimi i implementimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsim

- Gjatë këtij muaji u bë planifikimi i aktiviteteve të mëtutjeshme për implementimin e Strategjisë së Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë. Janë bërë përgatitjet e takimit të fundit të grupit punues në hartimin e planit të monitorimit të kësaj Strategjie, i cili takim do të mbahet në fillim të muajit qershor.

Mendohet, që pas këtij takimi të nxirret edhe drafti i dokumentit për monitorimin e Strategjisë dhe menjëherë të planifikohen edhe aktivitetet të cilat janë të parapara me projekt.

Mentorimi i projekteve për përkrahje të arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

■ Në kuadër të projektit “Mentorimi i projekteve për përkrahje të arsimimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian”, KEC ka vazhduar monitorimin e punës së organizatave “Durmish Aslano” në Prizren, “Qendra e Komunitetit Ashkali” në Dubravë dhe Bethany Christian Services (BCS) në Gjakovë. Edhe këtë muaj janë organizuar vizita në terren për të parë më afër mbarëvajtjen e punëve. Kështu, në datat, 21, 22 dhe 28 maj 2008 janë bërë vizita në të tri Qendrat.



Në përgjithësi ka një rritje të volumit të punës në këto Qendra në prag të fundvitit shkollor. Njashtu, pas tejkallimit të problemeve teknike, këtë muaj Qendra në Prizren ka filluar kursin e Gjuhës Angleze, ajo në Gjakovë kursin kundër analfabetizimit, ndërsa ajo në Buvravë kursin për kompjuter dhe internet.

■ Gjithashtu, gjatë këtij muaji është organizuar edhe një takim në Balkan Sunflowers për të koordinuar punët rreth

organizimit të një trajnimi të përbashkët për metodologjinë Hap pas Hapi për tutorët dhe fasilitatorët që punojnë në qendrat e komunitetit në komuna të ndryshme të Kosovës. Në këtë trajnim do përfshihem tutorë dhe fasilitatorë që punojnë në Qendrat që financohen nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) si dhe ato që financohen nga Balkan Sunflowers (BSF). Trajnimi do të organizohet në javën e parë të shtatorit.

Access Microscholarship Program

■ Gjatë muajit maj dy grupet e nxënësve nga rrafshi i Kosovës kanë përfunduar mësimin e gjuhës angleze. Të gjithë nxënësit janë pajisur me certifikata të cilat janë ndarë nga Ambasada Amerikane në Prishtinë.



Duke pasur parasysh se mësimdhënësja e tyre mbaroi kontratën e punës, u organizua edhe një aktivitet social me të gjithë nxënësit e këtyre dy grupeve.



Nxënësit u ndanë shumë të kënaqur me arritjet e tyre për mësimin e gjuhës angleze gjatë këtyre dy viteve e po ashtu edhe mësimdhënësja e tyre.

■ Në kuadër të këtij projekti janë duke u bërë përgatitjet edhe për certifikimin e grupit të nxënësve nga Prizreni e po ashtu edhe i një aktiviteti social mjaft të madh ku edhe me këtë aktivitet mbaron projekti i ACCESS-it. Aktiviteti parashihet të mbahet në Prevallë me të tri grupet e nxënësve që kanë ndjekur këtë kurs.

Trajnimi për mësimdhënësit e gjuhës angleze

Me përkrahjen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, është organizuar një trajnim i Gjuhës angleze për të gjithë mësimdhënësit e gjuhës angleze. Ligjërues i këtij trajnimi ishte Z. Michael Medley, profesor Universiteti nga SHBA



Trajnimet u mbajtën në të gjitha rajonet e Kosovës, në Prizren, Pejë, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë dhe Prishtinë.

Në të gjitha rajonet janë mbajtur trajnime – ligjërata me nga dy grupe nga secili rajon. Ndërsa në Prishtinë, trajnimi ka zgjatuar dy ditë dhe pjesëmarrës në

trajnim kanë qenë mësimdhënës nga të gjitha Rajonet e Kosovës. Mësimdhënësit të cilët e kanë ndjekur trajnimin në Prishtinë, u pajisën edhe me certifikata nga Ambasada Amerikane.



Të gjithë të certifikuarve u është dhënë edhe nga një set librash i cili set përmbante fjalor të gjuhës angleze dhe romane në gjuhën angleze.



Trajnimi kishte për qëllim ti aftësonte mësimdhënësit në metodologjinë e shkrimit dhe zgjidhjen e konfliktit në klasë.

Përgatiti: Petrit Tahiri